



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 323/ Prot
9

Tiranë, më 15/4/2022

VENDIM

Nr. 07, datë 15.4.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 323 Prot., datë 10.02.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Avokatura e Shtetit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuarit, ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 02.02.2022, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni se cilat janë firmat apo subjektet e kontraktuara nga ana e Shtetit Shqiptar dhe sa ka qenë kosto e kontraktimit e përcaktuar në kontratën e lidhur me këto firma, për të cilat mund të jetë kryer një kontraktim, për secilën nga çështjet e listuara si vijon:

1. *Albaniabeg Ambient v. Albania*
2. *Hydro v. Albania (I)*
3. *Hydro v. Albania (II)*
4. *Bankers Petroleum v. NANR Albania*
5. *Burimi and Eagle Games v. Albania*
6. *Sky Petroleum v. Albania*
7. *Mamidoil v. Albania*
8. *J&P Avax v. Albania*
9. *Hydro and others v. Albania*
10. *Tecnimonts.a v. KESH sh.a.*

11. *Vega shpk v Albania*
12. *XenofonKaragiannis v. Albania*
13. *Debt International Advisory v. OSHEE*
14. *GBC Oil v. Albania*
15. *Valeria Italia v. Albania*
16. *Kubota and Dondi v. Albania*
17. *Anglo-Adriatic Group v. Albania*
18. *Hydro S.R.L. (Italy) v. Republic of Albania, ICC Case No. 20654/EMT/GR*
19. *Durres Kurum Shipping v. Albania*
20. *Arka Energy v. Albania*
21. *Pantechniki v. Albania*
22. *ČEZ v. Albania*
23. *G.E. Transport and Athena v. Albania.*

Gjithmonë, nëse Autoriteti Publik për këto çështje ka kontraktuar firma të treta, shqiptare apo të huaja, për përfaqësimin e interesave të Shtetit Shqiptar në proceset e arbitrazhit ndërkombëtar (si përfaqësues të palës, konsulencë ligjore për të gjithë proceset, si në themel ashtu dhe për procedurë, pezullim dhe ndarje çështjesh dhe bllokim të ekzekutimit të vendimeve).

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 09.02.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “Avokatura e Shteti është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike. Sa i përket çështjeve të listuara në kërkesë, konkretisht nëse këto çështje janë përfaqësuar nga firma apo subjekte të kontraktuara nga ana e shtetit shqiptar dhe se cilat janë firmat e kontraktuara, se sa ka qenë kosto e kontraktimit e përcaktuar në kontratën e lidhur me këto firma për secilën prej çështjeve, komunikojmë se ky informacion, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” jepet përkatësisht sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”. Institucioni i Avokaturës nuk kontraktton/prokuron në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik, por në bazë të akteve nënligjore të saj, në zbatim të Ligjit organik “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. Gjithashtu, referuar parashikimeve të ligjit nr.10018/2008, i ndryshuar dhe VKM nr.392/2009, Avokatura e Shtetit nuk mban të dhëna mbi kostot e proceseve. Ato i transmetohen organit publik të interesuar për të cilin janë zhvilluar procedurat e kontraktimit”.

Pas përgjigjes së dhënë, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri me shkresën nr. 323/1 prot., datë 14.02.2022, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 646/1 Prot., datë 21.02.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 323/2 Prot., datë 21.02.2022, ka sqaruar se: *“...Sipas ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, neni 9 i tij, struktura përgjegjëse për ndjekjen e këtyre çështjeve është Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kjo strukturë, në përmbushje të detyrave të saj, lidhur me përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në arbitrazhin ndërkombëtar, ndër të tjerash, monitoron dhe ndjek çështjet e arbitrazhit në bashkëpunim me studion/t ligjore të kontraktuar/a për këtë qëllim, në rastet kur ka një të tillë të kontraktuar.*

Institucioni i Avokaturës së Shtetit ka proceduar me përzgjedhjen dhe kontraktimin e shërbimit të përfaqësimit për çështjet e specifikuar nga ankuesi, kjo në vlerësim të rëndësisë së çështjeve, në përputhje me procedurën dhe kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (në kohën kur këto procedura kontraktimi janë zhvilluar) përkatësisht neni 12 i VKM-së nr. 392, datë 8.4.2009 “Për miratimin e Rregullores” “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale” dhe pika 5 e VKM-së në fuqi, me nr. 381, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja” dhe VKM vijuese, VKM nr. 392, datë 8.4.2009, VKM-së nr.381, datë 12.6.2019 dhe ajo më e fundit nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”.

Kjo e fundit, në pikën 2 të saj, përcakton shprehimisht se: “Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, si dhe konfidencialitetit”.

Në vijim, Kreu III, Seksioni B, pika 8, Kreu IV seksioni B, pika 23 e vijues, i VKM-së parashikon konkretisht se: “Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin dhe renditien e ofertave apo rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje”.

Në përfundim të procedurës së kontraktimit, Avokatura e Shtetit nënshkruan në emër dhe për llogari të personit juridik të interesuar (i identifikuar si palë ndërgjyqëse në procesin e arbitrazhit në fjalë), kontratën me studion ligjore të shpallur fituese, të cilën i’a përcjell për ndjekje dhe mbulimin e kostove që rrjedhin prej saj, personit juridik të sipërcituar.

Gjithashtu, dhe në terma të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” e drejta për informim ka kufizimet e veta. Në nenin 17 të këtij ligji, parashikohen rastet e pengesave ligjore lidhur me sigurimin e informacionit dhe konkretisht:

1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

a) ...

b) sekretin tregtar;

2... dh) barazinë e palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor”

Bazuar në legjislacionin e mësipërm, vlerësojmë se informacioni për subjektet që përfaqësojnë shtetin shqiptar në proceset e arbitrazhit dhe vlerat përkatëse të kontraktimit, në mënyrë specifike, parashikohet se nuk mund t’u jepen as pjesëmarrësve ne procedura konkurrimi dhe as personave të tretë (në të cilin përfshihet edhe ankuesi). Qëllimi i këtyre parashikimeve ka qenë respektimi i parimit të konfidencialitetit, marrëdhënies avokat - klient, si dhe ruajtjes të interesave të shtetit shqiptar.

Sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të vlerësoni se informacioni i kërkuar nga ankuesi është brenda kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe i nënshtrohet rregullave të konfidencialitetit, për këto arsye, nuk mund ta vendosim në dispozicion të personave të tretë”.

Në vijim, ankuesi pretendon se: “...Është e vërtetë që, VKM-ja e cituar nga Avokatura e Shtetit parashikon në nenin 25 se “Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave komisioni njofton me shkrim/elektronikisht individualisht secilin ofertues lidhur me vlerësimin e ofertës së tij. Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin dhe renditjen e ofertave apo rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë”, por ky parashikim, lidhet në mënyrë të pandashme me procesin e vlerësimit të ofertave për pjesmarrje në tender dhe përcaktimin e ofertës fituese. Ky parashikim është specifikisht i hedhur në letër për qëllim të ruajtjes së barazisë në tender mes pjesmarrësve dhe lidhet në mënyrë të pandashme me procesin e tenderit të hapur. Në asnjë rast nuk është kërkuar informacion mbi ofertat në tenderat për arbitrazhet e cituara në kërkesën për informacion, apo për ofertat e palëve të interesuara. Kërkesa e paraqitur lidhet shprehimisht me kontratat e lidhura në përfundim të këtij procesi konfidencial dhe koston e tyre për buxhetin e shtetit. Vetë ky nen, në vijim parashikon “Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.” duke e qartësuar që konfidencialiteti lidhet në mënyrë të pandashme dhe ekskluzive me procesin e tenderimit, dhe jo me proceset vijuese.

Edhe për sa i përket konfidencialitetit të të dhënave e cituar nga Avokatura e Shtetit si arsyetim për mosdhënien e informacionit, është e vërtetë që shumica e këtyre VKM-ve të ndryshuara ndër vite parashikojnë që “Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve/studiove të avokatisë vendase ose të huaja, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, të mosdiskriminimit, të transparencës, të trajtimit të barabartë të ofertuesve, duke ruajtur konfidencialitetin e sekretin tregtar të subjekteve”, por ajo lidhet shprehimisht me

sekretin tregtar të këtyre subjekteve për sa i përket procedurës së ofrimit dhe vlerësimit të ofertave për shërbime, që është dhe bërthama e të gjithë këtyre VKM-ve, dhe jo kontratën pasardhëse. Për më tepër, edhe kërkesa për informacion lidhet vetëm me faktin se sa prej procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar kanë pasur përfaqësim nga studio apo subjekte të treta dhe sa ka qenë kosto e këtij përfaqësimi apo asistence ligjore. Në asnjë rast nuk është kërkuar as strategjia e mbrojtjes, e punës, zhvillimet dhe komunikimet mes palëve në kontratë apo çdo lloj informacioni tjetër i cili mund të përbëjë në një formë apo në një tjetër element për sekret tregtar. Informacioni i kërkuar është i qartë dhe i thjeshtë: Sa i ka kushtuar buxhetit të shtetit kontraktimi i këtyre studiove për mbrojtjen e interesave shtetërore, një informacion që duhet të jetë në çdo kohë publik.

Edhe për sa i përket citimit nga Avokatura e Shtetit të nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit se dhënia e këtij informacioni mund të prishë barazinë e palëve në një proces gjyqësor apo çënon sekretin tregtar është disi i pakuptimtë. Për sa kohë në një proces arbitrazhi, të gjithë kostot administrative shpallen dhe bëhen publike nga palët për tribunalin në mënyrë që këto të merren parasysht në dispozitivin përfundimtar, është e paqartë se si kjo info mund të prishë pozitën e shtetit shqiptar në këto procese, shumica e të cilëve tashmë janë mbyllur përfundimisht. Ndërkohë për sa i përket sekretit tregtar për të cilin ende nuk ka një sqarim të qartë se ku qendron dëmi potencial, si për procese që tashmë janë mbyllur prej vitesh, po ashtu dhe në procese për të cilat procedura e vlerësimit të ofertave për përfaqësim ka mbaruar, procedurat e ankesave janë mbyllur, dhe janë konkluduar kontratat përkatëse.

Më tej, në kuadër të parashikimeve të nenit 17 dhe klauzolës së interesit publik më të lartë, qendra jonë (Albanian Center for Quality Journalism) është një organizatë mediatike e cila është duke shqyrtuar kontratat e përfaqësimit në procedura arbitrazhi të lidhura nga shteti shqiptar ndër vite, efektivitetin e tyre në këto procedura ndërkombëtare dhe koston për buxhetin e shtetit, duke e vlerësuar këtë informacion si me interes të lartë publik.

Nën këtë arsyetim, kërkesa e tejkalon interesin e Avokaturës së Shtetit për mosdhënien e informacionit, gjithmonë nëse parashikimet ligjore në fjalë mund të aplikohen, gjë që nuk qëndron dhe minimumi që mund të bëhet nga institucioni përkatës është të jepet një argumentim shterues se në cilën mënyrë dëmtohen interesat e cituara nëse jepet informacioni i kërkuar për procedura tashmë të mbyllura.

Për sa i përket pretendimit nga Avokatura e Shtetit se nuk disponon informacion mbi koston e këtyre kontratave, është vetë kjo e fundit e cila e pranon në shkresën e saj se ajo nënshkruan kontratat me firmat e treta në emër të autoritetit kontraktues dhe më pas ja kalon për mbulim të shpenzimeve institucioneve përkatëse.”

Në këto kushte, ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.323/3 Prot., datë 01.03.2022.

Pas vijimit të ankimit, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 19, datë 04.03.2022, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

Personale (në vijim “Komisioneri”) vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 09.03.2022.

Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ i cili u protokollua me nr. 646/2 Prot., datë 07.03.2022.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit kërkoi të kontaktoi me nëpunësit, të cilët kanë trajtuar kërkesën për informacion për të konfirmuar nëse dokumentacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi.

Përfaqësuesja e Autoritetit Publik sqaroi se: *“I qëndrojnë shpjegimeve të dhëna me shkrim në shkresën nr. 646/1 Prot., datë 21.02.2022, në të cilën vlerësohet se është shpjeguar qartë baza ligjore e aplikueshme në lidhje me çështjen dhe pozicioni i Avokaturës së Shtetit në lidhje me procedura të kësaj natyre. Gjithashtu, bën me dije se informacioni i kërkuar nuk mbahet/ruhet në Avokaturën e Shtetit në formën e statistikave apo të dhënave të tjera të përpunueshme, siç kërkuesi i pretendon. Nga ana tjetër, kërkuesi mund t’i aksesojë këto të dhëna në vendimet e njohjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ku janë të depozituara vendimet e arbitrazhit të cituara (të gjitha apo disa prej tyre këtë informacion nuk e disponojnë), nga ku mund të dalin palët, përfaqësuesit dhe kostot e procesit, por Avokatura e Shtetit nuk mund t’i vendosë në dispozicion pasi palë në këto procese janë institucionet e ngarkuara me ekzekutimin e tyre.”*

Për shkak të nevojës së zhvillimit të një seance dëgjimore, Komisioneri, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 323/5 Prot., datë 25.03.2022 “Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative”, vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 15.04.2022.

Në vijim, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenet 41,64,77 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 323/7 Prot., datë 28.03.2022, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 11.04.2022 me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.*

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar nga Autoriteti Publik, t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni i kërkuar në formatin që ky i fundit e zotëron.

Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik cituan qëndrimin e Avokaturës së Shtetit të reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, si dhe sqaruan se: *“...Natyra e arbitrazhit, si një mjet alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, është tërësisht konfidencial. Parimi gjatë një gjykimi në arbitrazh është: procesi në tërësi mbrohet nga*

konfidencialiteti që nga momenti i fillimit të tij, nëse është parashikuar paraprakisht në instrumentin objekt shqyrtimi gjyqësor, apo nga momenti i vendimmarrjes së aplikimit të konfidencialitetit, nëse kërkohet kryesisht. Konfidencialiteti në proceset e arbitrazhit që kanë përfshirë shtetin Shqiptar ka mbuluar dhe mbulon të gjithë procesin, rrjedhimisht institucioni i Avokaturës së Shtetit e ka objektivisht të pamundur të komunikojë apo ndajë informacion me institucione të tjera të administratës shtetërore/çfarëdo palë të treta të cilat mund të paraqesin interes në çështje, përveç komunikimit që mban me institucionin i cili është palë e paditur apo paditëse në proces. Gjithashtu, në rastin konkret gjejnë vend gjithashtu dhe parimet e konfidencialitetit në marrëdhëniet avokat – klient. Pavarësisht se Avokatura e Shtetit është një institucion publik, funksioni i saj i vetëm është ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes ndaj shtetit shqiptar e konkretisht avokatit. Bëhet një dallim mes mbrojtjes që zhvillon një institucion mes grupit të vetë juristëve dhe mbrojtjes që zhvillon një institucion mes grupit të vetë të juristëve dhe mbrojtjes që bën Avokatura e Shtetit si institucion qendror që mbron interesat pasurore të shtetit. Në këtë kuptim, marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet e tjera, apo palët private të përfshira në një procedurë administrative në lidhje me përfaqësim mbrohen nga parimi i konfidencialitetit “avokat – klient”, këto bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” si dhe detajuar më tepër në Kodin Etik i Avokatit miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Rrjedhimisht, institucioni i Avokaturës së Shtetit, si përfaqësuese e Shtetit Shqiptar apo institucioneve të posaçme të tij/enteve publike, e ka të pamundur të bëjë publike të dhëna, të cilat i janë komunikuar në procedura administrative, të cilat kanë kërkuar t’i bashkohen Avokaturës së Shtetit Shqiptar para një tribunali të arbitrazhit ndërkomëtar.”

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik qëndrimin përfundimtar lidhur me ankesën, brenda datës 13.04.2022.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 13.04.2022, sqaroi se: “...Avokatura e Shtetit, pasi u njoh me një nga kërkesat e ankuesit, që kishte të bënte me numrin e çështjeve të arbitrazhit, në formë statistikore, që janë përfaqësuar nga avokatë të huaj të kontraktuar nga Avokatura e Shtetit, ju informon se një informacion të tillë ia ka dhënë më parë kërkuarit. Në procesin e administrativ të datës 14.01.2022, në përgjigje të pyetjes numër dy të ngritur nga kërkuari, Avokatura e Shtetit ka sqaruar se janë 10 (dhjetë) procese për të cilat ka kontraktuar shërbim. Gjithashtu, duke qenë se në seancë kërkuari, konfirmoi se ka informacion në lidhje me shumat kontraktore dhe pagesat e avokatëve të huaj, dijeni të cilën e ka marrë nga Ministria e Financave, konstatojmë se kërkesa e tij ka mbetur pa objekt, dhe konfirmon pretendimin tonë, që ky informacion mund të merret drejtpërdrejtë nga institucionet e përfaqësuar nga ana jonë ose pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (për ato vendime që janë njohur).

Në përfundim, Avokatura e Shtetit, pa dashur të përsërisë rrethanat e faktit dhe argumentet e shprehura në seancën e datës 11.04.2022, u qëndron parashtrimeve duke kërkuar përfundimisht: “Rrëzimin e kërkesës së z. Roden Hoxha”.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Avokatura e Shtetit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Nga shqyrtimi i objektit të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, informacioni i kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, bazuar kjo në shkronjën ë) të pikës 1 të nenit 7 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme”*. Detyrim ky i cili nuk rezulton i përmbushur nga Autoriteti Publik.

Konstatohet se, procedurat e prokurimit të Autoriteti Publik janë zhvilluar bazuar në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndyshuar dhe legjislacionin në fuqi (në kohën kur këto procedura kontraktimi janë kryer) përkatësisht: VKM-ja nr.392, datë 8.4.2009 “Për miratimin e Rregullores” “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”, VKM-ja nr. 381, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja” dhe VKM-ja nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për kontraktimin e pagesën e

avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”.

Në këto kushte, pavarësisht legjislacionit të aplikueshëm për zhvillimin e procedurave të kontraktimit, si dhe përjashtimit të Autoritetit Publik nga zbatimi i Ligjit për prokurimin publik, vlerësohet se ky fakt nuk passjell përjashtimin e këtij autoriteti nga zbatimi i LDI.

Nga tërësia e argumentave të paraqitura nga Autoriteti Publik, për refuzimin e vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar, së pari vlerësohet se ato janë kontradiktore dhe të pabazuara në asnjë dispozitë ligjore apo provë që të legjitimojë kufizimin e dhënies së informacionit sipas nenit 17 të LDI. Autoriteti Publik referon ndër të tjera si shkaqe kufizimi të informacionit konfidencialitetin e procedurave të arbitrazhit, por edhe konfidencialitetin në marrëdhënien Autoritetit Publik avokatë/zyra avokatie të kontraktuara për përfaqësimin e shtetit shqiptar në proceset e arbitrazhit.

Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik sipas të cilit”... *Parimi gjatë një gjykimi në arbitrazh është: procesi në tërësi mbrohet nga konfidencialiteti që nga momenti i fillimit të tij, nëse është parashikuar paraprakisht në instrumentin objekt shqyrtimi gjyqësor, apo nga momenti i vendimmarrjes së aplikimit të konfidencialitetit, nëse kërkohet kryesisht. Konfidencialiteti në proceset e arbitrazhit që kanë përfshirë shtetin Shqiptar ka mbuluar dhe mbulon të gjithë procesin, rrjedhimisht institucioni i Avokaturës së Shtetit e ka objektivisht të pamundur të komunikojë apo ndajë informacion me institucione të tjera të administratës shtetërore/çfarëdo palë të treta të cilat mund të paraqesin interes në çështje, përveç komunikimit që mban me institucionin i cili është palë e paditur apo paditëse në proces...*”, është plotësisht i pabazuar.

Në pikën 6 të nenin 17 të LDI, parashikohet se: “.....*Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim.*”. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkeses për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë. Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se *procesi i arbitrazhit në tërësi mbrohet nga parimi i konfidencialitetit.*

Ndryshe nga sa pretendon Autoriteti Publik, në procese arbitrazhi me palë “shtet”, për shkak të interesit të drejtëpërdrejtë të publikut në këto procese, parimi i konfidencialitetit nuk gjen zbatim në tërësi, pasi duhet të garantohet së pari transparenca ndaj interesave dhe pasurisë publike, llogaridhënia dhe kontrolli ndaj veprimeve të administratës shtetërore/publike.

Për më tepër, objekti i kërimit nuk lidhet me informacion përsa i përket procesit të gjyqimit nga gjykata e arbitrazhit, por me veprime me karakter administrativ të Autoritetit Publik të cilat nuk mund t'i nënshtrohen *a priori* klauzolës së konfidencialitetit të një procesi arbitrazhi, nëse procesi në vetvete ka një të tillë.

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se: “Bazuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, kjo e fundit, në pikën 2 të saj, përcakton shprehimisht se: “Procedura për kontraktimin dhe përzgjedhjen e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja do të kryhet në përputhje me parimin e konkurrencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë të ofertuesve, si dhe konfidencialitetit”. Në vijim, Kreu III, Seksioni B, pika 8, Kreu IV seksioni B, pika 23 e vijues, i VKM-së parashikon konkretisht se: “Informacionet për shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin dhe renditjen e ofertave apo rekomandimet për ofertën fituese nuk u bëhen të njohura ofertuesve ose personave të tjerë. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje”, edhe ky argument gjendet i pabazuar.

Nga analizimi i kësaj dispozite rezulton qartë se procedura konfidenciale lidhet vetëm me procedurën e shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe renditjes së ofertave. Një paralel i qartë me parashikimet ligjore për konfidencialitetin e ofertave në procedurat që ndiqen në Ligjin për prokurimin publik, ku në vijim të pranimit të ofertës fituese, çdo kontratë publike duhet të bëhet publike. Pra, procedurat kontraktore të kësaj natyre, është e vërtetë që përjashtohen nga aplikimi i Ligjit për prokurimin publik, por në asnjë rast nuk përjashtohen nga aplikimi i dispozitave të LDI.

Gjithashtu, nga verifikimi i legjislacionit të sipërcituar, për zhvillimin e këtyre procedurave, nuk rezulton që kontrata e lidhur me subjektin privat (e cila përmban informacionin objekt kërkimi) të parashikohet si informacion konfidencial, për të autorizuar lidhjen e një kontrate të tillë dhe legjitimitimin e Autoritetit Publik për kufizimin e të drejtës për informim të qytetarëve.

Nga ana e Autoritetit Publik, janë cituar dispozita të përgjithshme ligjore që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, sekretin tregtar apo marrëdhëniet e besimit avokat klient, por nuk është argumentuar saktësisht se si dhënia e këtij informacioni mund të çënojë apo shkelë këto parime.

Lidhur me argumentin e dhënë nga Autoriteti Publik se dhënia e informacionit ndalohe sipas nenit 10 të ligjit nr. 55/2018 “Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri vlerëson se ligji i sipërcituar rregullon profesionin e avokatisë si profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar ndërsa avokati i shtetit është nëpunës civil dhe parimet e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit janë të cituara në nenin 3 të Ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. Për më tepër asnjë nga elementët që karakterizojnë profesionin e avokatisë si profesion i lirë nuk mund t’i vishet rolit të Avokaturës së Shtetit e cila, bazuar në pikën 1 të nenit 2 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar është institucioni qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Bazuar në këtë përcaktim, Avokatura e Shtetit klasifikohet si Autoritet Publik në kuptim të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI dhe

rrjedhimisht nuk mund të refuzojë vënien në dispozicion të dokumenteve që ajo zotëron apo prodhon në kuadër të përmbushjes së detyrave të saj publike.

Ndërkohë, lidhur me sekretin tregtar në pikën 2 të nenit 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar parashikohet se: “Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëlqjen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se *informacioni i kërkuar nuk mbahet/ruhet në Avokaturën e Shtetit në formën e statistikave apo të dhënave të tjera të përpunueshme, siç kërkuesi i pretendon, bazuar edhe në legjislacionin e sipërcituar*, rezulton se ky informacion disponohet nga ai, por jo në format të përpunueshëm.

Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: “*Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik*”, Komisioneri vlerëson se, këto dokumente të cilat përfshijnë informacionin e kërkuar, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Ndërkohë lidhur me argumentin se, *kërkuesi mund t’i aksesojë këto të dhëna në vendimet e njohjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ku janë të depozituara vendimet e arbitrazhit të cituara (të gjitha apo disa prej tyre këtë informacion nuk e disponojnë), nga ku mund të dalin palët, përfaqësuesit dhe kostot e procesit, por Avokatura e Shtetit nuk mund t’i vendosë në dispozicion pasi palë në këto procese janë institucionet e ngarkuara me ekzekutimin e tyre*, Komisioneri e gjen të pabazuar për shkak se Autoriteti Publik nuk rezulton që të ketë trajtuar kërkesën për informacion, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, në të cilën parashikohet se:

2. “*Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarin.*”

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuarin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa.”*

Gjithashtu, në germën “d”, të pikës 2, neni 10 i LDI, parashikohet se: “*koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar*”.

Për sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se: “*kërkesa ka mbetur pa objekt sqarojmë pasi kërkuesi konfirmoi se ka marrë informacion dhe nga autoritete të tjera publike*”

Komisioneri sqaron se, as dispozitat e LDI as nenet 90, 93-96 të Kodit të Procedurave Administrative, nuk parashikojnë përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankesës sipas nenit 24 të LDI, në një rrethanë të tillë. Dispozitat e LDI nuk kushtëzojnë marrjen e informacionit publik vetëm nga një autoritetit publik, po ashtu kërkuesi vijoje qartësisht ankimin e tij ndaj Autoritetit Publik dhe i qëndroi cdo pikë të kërkimit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 323 Prot., datë 10.02.2022, nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Avokatura e Shtetit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas ankesës nr. 323 Prot., datë 10.02.2022 duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 27.4.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 15.4.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

